



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 340 Akti

Nr. 403 Vendimi
Tiranë, më 18.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 16.6.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ali Koleci**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Aneksi i Kushtetutës Së Republikës Së Shqipërisë** miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 842016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Ali Koleci ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, deri më datë 18.03.2020, datë në të cilën ka ndërruar jetë.
2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjedh me shortin e hedhur, më datë 12.11.2019, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim “Komisioni”).
3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues, me këtë përbërje: komisioner Lulzim Hamitaj me cilësinë e relatorit dhe me cilësinë e anëtarit komisionerët: Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari.
4. Trupa gjykuese në mbledhjen e datës 12.11.2019, me vendimin nr.1 të po kësaj date, ka caktuar me mirëkuptim kryesuesen e trupit gjykues znj. Xhensila Pine, ku dhe u deklarua mospasia e konfliktit të interesit nga ana e secilit prej anëtarëve të trupës gjykuese. Më tej, në datën 21.11.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, e po në këtë datë subjekti i rivlerësimit konfirmoi se nuk kishte konflikt interesi me trupën gjykuese.
5. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016.
6. Komisioni referuar disa burimeve mediatike jo zyrtare, mori dijeni se subjekti i rivlerësimit z. Ali Koleci kishte ndërruar jetë, në këto kushte Komisioni me shkresën nr. *** prot, datë 11.03.2021, iu drejtua Këshillit të Lartë të Gjyqësor, duke i kërkuar informacion lidhur me stadin aktual të gjyqtarit z. Ali Koleci.
7. Këshilli i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. *** prot, datë 18.03.2021, ka informuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me shkresën nr.*** prot, datë 09.06.2020, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. *** prot, datë 11.06.2020, ka bërë me dije se më datë 18.03.2020, ka ndërruar jetë gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke vënë në dispozicion certifikatën e vdekjes nr. ***, datë 10.04.2020, lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Nr.***, Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë.

II. ARSYETIMI I KOMISIONIT

8. Subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Ali Koleci, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka dërguar dhe plotësuar dokumentacionin, si vijon:
 - a. Deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31 të ligjit;

- b. Deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35 të tij;
 - c. Formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41 të tij.
9. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim të nenit 90, pika 3, të ligjit nr. 44/20151, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi”* dhe të nenit 93, ku parashikohet: *“Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen”*.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenet 9 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit Ali Koleci.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.6.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Xhensila Pine
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI

Lulzim HAMITAJ

Anëtar

Relator

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi